



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRN	
01 Nr. / Br	150/24
Nr. i fq. / Br. st	-1-
Data: / Datum	25. 07. 2024
VUSHTRRI - VUÇITRN	



## Republika e Kosovës

## Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 13.1, pika "a" të Ligjit mbi Tokën Bujqësore nr.02/L-26, nenit 12.2 "d", 14 .1 dhe 17 "c" lidhur me pikën "s" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, si dhe nenin 19, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, në lidhje me nenin 17, paragrafët 6,7 dhe 11 të Statutit të Komunës Nr.01-209/22, Vendimin e Kuvendit të Komunës 01.nr.126/17 për Aprovimin e Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Vushtrrisë 2016-2024, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **25 korrik 2024** mori këtë:

### V E N D I M

### PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E LAPIDARIT NË FSHATIN PASOMË

1. Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e lapidarit në fshatin Pasomë, pjesë nga parcela kadastrale P-70202050-01296-0 në sipërfaqe prej 613 m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 89886 m<sup>2</sup>, me kulturë kullosë e kl.4 ZK - Pasomë, e cila evidentohet si pronë e Komunës së Vushtrrisë.
2. Me këtë vendim lejohet ndërrimi i destinimit të patundshmërisë të cekur në nenin 1 të këtij vendimi, kurse me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, obligohet Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë që të bëjë ndërrimin e destinimit (kulturës) së kësaj parcele në elaboratin kadastral.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër, dhe Pronë, si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.
4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**



Kryesuese e Kuvendit



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 151/24  
Nr. i fq. / Br. st -1-  
Data: / Datum 25.07.2024  
VUSHTRRI - VUÇITRN



## Republika e Kosovës

## Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2 shkronja "d" dhe 14 paragrafi 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, nenit 13 paragrafi 1 pika 1.4, 18 paragrafi 1 pika 1.13 dhe 19 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë dhe Vendimin e Kuvendit të Komunës 01nr.126/17 për Aproximin e Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Vushtrrisë 2016-2024, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **25 korrik 2024**, merr këtë:

### VENDIM PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIM TË LAPIDARIT NË FSHATIN DUMNICË E POSHTME

1. Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtim të lapidarit për të rënë për Liri nga fshati Dumnicë e Poshtme, Komuna e Vushtrrisë, kundër pushtuesit serb, para, gjatë dhe pas luftës së dytë botërore.
2. Ndërtimi i lapidarit do të bëhet në parcelën kadastrale P-70202026-00704-0, në sipërfaqe prej 450 m<sup>2</sup>, vendi i quajtur "Shpoti", dhe në pjesë të parcelës kadastrale P-70202026-00703-0 në sipërfaqe prej 1500 m<sup>2</sup> nga sipërfaqja e përgjithshme prej 3283 m<sup>2</sup>, vendi i quajtur "Shpati Gazhjan", Zona Kadastrale Dumnicë e Poshtme, pronë e Komunës së Vushtrrisë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë që do të bëjnë shenjëzimin e sipërfaqes në parcelën nga pika 1 e këtij vendimi si dhe regjistrimin në RDPP dhe dokumentet tjera të parapara me legjislacionin në fuqi.
4. Financimi i realizimit të këtij projekti do të bëhet nga komuniteti i fshatit Dumnicë e Poshtme. Këshilli i këtij fshati do të sigurojë listën e emrave të cilët do të shkruhen në lapidar.
5. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: Kërkesa e përfaqësueseve të fshatit Dumnicë e Poshtme, Lista me nënshkrime, Lista e emrave të cilët do të shkruhen në lapidar dhe certifikata mbi të drejtën e pronës dhe kopja e planit.
6. Ky Vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi



Kryesuese e Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRAN	
01 Nr. / Br	152/24
Nr. i fq. / Br. st	-1-
Data: / Datum	25.07.2024
VUSHTRRI - VUÇITRAN	



## Republika e Kosovës

## Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2 shkronja "d" dhe 14 paragrafi 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, nenit 13 paragrafi 1 pika 1.4, 18 paragrafi 1 pika 1.13 dhe 19 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë dhe Vendimin e Kuvendit të Komunës 01nr.126/17 për Aprovimin e Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Vushtrrisë 2016-2024, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **25 korrik 2024**, merr këtë:

### VENDIM PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E PLLAKËS PËRKUJTIMORE

1. Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e pllakës përkujtimore për ish-komandantin e UÇK-së dhe Komandantin e Policisë së Kosovës z.Milaim Fejzullahu në fshatin Shalë/Shallc, në parcelën kadastrale P-70202069-00341-0 në sipërfaqe prej 959 m<sup>2</sup>, me kulturë kullosë e kl.4 ZK - Shalë/Shallc, e cila evidentohet si pronë e Komunës së Vushtrrisë.
2. Aprovohet peticioni i banorëve të fshatit Shalë/Shallc, me Nr.02-104/02-17682/24 i datës 22.04.2024 i parashtruar në emër të z.Sabri Fejzullahu, me të cilin është kërkuar rregullimi i një paraku në fshatin Shallc dhe vënia e pllakës përkujtimore për ish-komandantin e UÇK-së dhe Komandantin e Policës së Kosovës z.Milaim Fejzullahu.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, që do të bëjnë shenjzimin e sipërfaqes në parcelën nga pika 1 e këtij vendimi si dhe regjistrimin në RDPP dhe dokumentet tjera të parapara me legjislacionin në fuqi.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: Kërkesa e përfaqësueseve të fshatit Shallc, certifikata mbi të drejtën e pronës dhe kopja e planit.
5. Ky Vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**



**Kryesuesë e Kuvendit**